



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 349/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, - Bayhan Lopari, vëzhgues, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) – Kryesuesit të vendvotimit 2004/08D, për shkak të përjashtimit nga vendvotimi, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.349/2019 e datës 07.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren - Bayhan Lopari, vëzhgues, kundër Kryesuesit të vendvotimit 2004/08D, me të cilën ka kërkuar që të verifikohet procesi i votimit, për shkak të përjashtimit të ankuarit nga vendvotimi 2004/08D.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), përkatësisht Bayhan Lopari vëzhgues i këtij subjekti ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.349/2019, me të cilën pretendon se mua si vëzhgues nuk më është lejuar të monitoroj procesin e votimit në qendren e votimit 2004/08D në Prizren. Prandaj kërkoj menjëherë të verifikohet procesi. Si provë parashturesi i ankesës ka bashkangjitur dokumentin e identifikimit të vëzhguesit.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se pala ankuuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e pengimit të tij që të vëzhgoj procesin e votimit, dhe nuk e ka dëshmuar në ankesën e tij se a ka qenë vëzhgues i akredituar për zgjedhjet e datës 06.10.2019,

Ndërsa menaxheri i Qendrës së Vendvotimit në përgjigje në ankesë thekson se nuk janë të sakta fare pretendimet e paraqitësit të ankesës sepse i njëjti nuk ka qenë i pajisur me begjin e vëzhguesit dhe gjatë tërë ditës ka qëndruar jashtë, në korridor (këtë mund ta vërtetojmë edhe

me anë të incizimeve të kamerave të shkollës), dhe asnjëherë gjatë gjithë ditës nuk na janë afruar neve si staf menaxhues për tu ankuar për një gjë të tillë.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Nystret Bytyqi i ZLKZ-së në Prizren deklaroi se në rastin e ankesës Anr.349/2019, në Qendren e Votimit të cekur në ankesë, unë si zyrtar Komunal nuk kam pranuar asnjë ankesë apo informatë mbi këtë dhe nuk më është raportuar për këtë rast.

Po ashtu, sipas kërkesës së PZAP-së, me datë 08.10.2019 është përgjigjur ankesës edhe znj. Sema Gushi – komisionere/kryesuese, e cila deklaroi se Bayhan Lopar i cili ka qenë vëzhgues në subjektin KDTP, ka qenë në dhomë në ora 07:00 të mëngjesit dhe nuk ka qenë në dhomë tërë ditën me vëzhgu, ai ka ardh në mbledhje para se të mbyllet votimi dhe mua më pyeti a më ke shënuar në libër, unë i thash që jo pastaj edhe komisioneri nga KDTP u afrua dhe ai vet nuk e pranoi që të shkruaj emrin e Bayhan-it sepse nuk ka qenë në dhomë tërë ditën dhe të gjithë vëzhguesit dhe komisionerët e tjerë të partive nuk më kanë lejuar të shkruaj emrin e tij. Unë nuk e di kush nuk e ka lënë të vëzhgoj ai në klasë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me përjashtimin që ju është bërë nga kryesuesi i vendvotimi 2004/08D, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, duke u mbështetur edhe në përgjigjet e KQZ-së, ZLKZ-së dhe Sema Gushi – komisionere/kryesuese, nuk mundi të konstatojë faktin se Bayhan Lopari, është përjashtuar nga qendra e Vendvotimit 2004/08D, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), përkatësisht Bayhan Lopari vëzhgues, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e në procesin e votimit me datën 06.10.2019, në vendvotimin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.349/2019 më datën 10.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.